

VENDIM
Nr. 44, datë 20.9.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 47, DATË 13.6.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME DIBËR”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.9.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 47, datë 13.6.2018 ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër’””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër (UK Dibër), me shkresën nr. 454 prot., datë 16.7.2019, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Dibër për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe me procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Dibër, me vendimin nr. 47, datë 13.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Dibër sh.a., z. Bedri Kamberi, ka mbaruar studimet e larta në Agronomi dhe Bio-Kimi dhe ka shërbyer edhe më parë si drejtues ligjor i kësaj shoqërie nga viti 2012 deri në vitin 2015.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Dibër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Dibër është i bazuar ligjorisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 47, datë 13.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor z. Bedri Kamberi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani